

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Arrestohet Kastriot Hasko dhe dy ish-drejtorë të ASHK Fier, akuzohet për falsifikimin e 1143 hektarëve në Fier! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/arrestohet-kastriot-hasko-dhe-dy-ish-drejto-re-te-ashk-fier-akuzohet-per-falsifikimin-e-1143-hektareve-ne-fier/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 17:22:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 17:10:43 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d83d59d4d05d317b9539e6f2668f8c901a51e9e9cb22cd800f0a2282ff12bce0
TEKSTI	7b94309a543b0fa4cdcca051cfec04b77ce2b136ddf62263811768d31704d998
PAMJA	3b8c2891f9d7aab6f84de9f7ca5d608ba2e2267f4a58a0e6f3a1cce03efa1e23

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0fa6134cefb76ca3639fda12ea4d1a5c628c2d7ceaff9e351b26e4d7a0a23558
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a0e62f20f1566f1a6ab80e6e4e50c1c4744bc54a84695e6ceb27bc326e386c4d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0fa6134cefb76ca3639fda12ea4d1a5c628c2d7ceaff9e351b26e4d7a0a23558>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Aktualitet

Arrestohet Kastriot Hasko dhe dy ish-drejtorë të ASHK Fier, akuzohet për falsifikimin e 1143 hektarëve në Fier!



Ervin Nikolla

17 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Me kërkesë të Prokurorisë së Fierit, është vënë në pranga sot Kastriot Hasko, i akuzuar si përfituesi i paligjshëm i pronave, **nën akuzë** për veprat penale 'Falsifikim i dokumenteve', së bashku me Ertis Shehu dhe Bardhyl Kapaj, ish-drejtorë të ASHK-së Fier.

Sipas prokurorisë, Hasko, duke paraqitur si tituj pronësie dy vendime të falsifikuara të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Fier, ka arritur të regjistrojë në bashkëpronësi të tij dhe katër personave të tjerë një sipërfaqe të konsiderueshme toke prej 1,143 hektarë të ndodhur në zonat kadastrale 3301 dhe 3358, Seman i Ri dhe Sheq Marinas, Fier.

Më pas, ky shtetas, duke u paraqitur me cilësinë e bashkëpronarit dhe përfaqësuesit edhe të bashkëpronarëve të tjerë, me anë të një prokure të posaçme të falsifikuar, u ka shitur këtë tokë dy shoqërive të ndryshme.

Njoftimi:

Arrestohen me kërkesë të Prokurorisë Fier për falsifikim dokumentesh e shpërdorim detyre, dy ish-drejtorë të ASHK-së, specialisti dhe përfituesi i pronës, sekuestrohen 1143 ha tokë

Me kërkesë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier u vendos masa e sigurimit personal 'Arrëst në burg' ndaj katër shtetasve E.Sh., B.K. në cilësinë e drejtorëve të ASHK, P. Ç. specialistit, jurist, pranë ASHK dhe K.H., përfituesi i pronave nën akuzë për veprat penale 'Falsifikim i dokumenteve', 'Shpërdorimi i detyrës' si dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale" të parashikuara nga nenet 186/2, 248 dhe 287, prg.2, të Kodit Penal.

Po kështu, në kuadër të hetimeve u sekuestruan mbi 76 pasuri, me sipërfaqe totale prej 1143 hektarë tokë (e barabartë me njëmbëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e gjashtë m²), si dhe 150.000 euro.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier gjatë hetimeve të deritanishme për procedimin penal nr. 1026 të vitit 2025, kryer në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, nëpërmjet përdorimit edhe të metodave proaktive, arriti të provojë se:

Shtetasi K.H., duke paraqitur si tituj pronësie dy vendime të falsifikuara të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Fier, ka arritur të regjistrojë në bashkëpronësi të tij dhe katër personave të tjerë një sipërfaqe të konsiderueshme toke prej 1,143 hektarë si dhe 150.000 Euro të ndodhur në zonat kadastrale 3301 dhe 3358, Seman i Ri dhe Sheq Marinas, Fier.

Më pas, ky shtetas, duke u paraqitur me cilësinë e bashkëpronarit dhe përfaqësuesit edhe të bashkëpronarëve të tjerë, me anë të një prokure të posaçme të falsifikuar, u ka shitur këtë tokë dy shoqërive të ndryshme.

Shtetasit E.Sh. dhe B.K., në cilësinë e drejtorëve të ASHK, Fier, dhe shtetasi P.Ç., në cilësinë e specialistit, jurist, pranë ASHK, Fier, kanë regjistruar pasuritë në fjalë në bashkëpronësi të shtetasit K.H., në kundërshtim me ligjin nr. 111/2018, "Për kadastrën", dhe ligjin nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe VKM nr. 639, datë 16.10.2024, dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit", duke mos kërkuar sipas këtyre akteve ligjore/nënligjore konfirmimin e vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Fier nga Agjencia e Trajtimit të Pronës, verifikim nga i cili do të rezultonte se këto vendime janë të falsifikuara.

Për më tepër, ka rezultuar se shtetasi B. K., ish drejtor i ASHK, Fier, kur ka regjistruar pasurinë nr. 3**, zk 3358, ka tejkualuar edhe sipërfaqen që sipas vendimit të falsifikuar nr. 8*, datë 20.01.1997, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pranë Këshillit të Rrethit Fier, i ishte kthyer ish-pronarit Th.S., duke përfituar për rrjedhojë shtetasi K.H. edhe një sipërfaqe tjetër të konsiderueshme toke në pronësi.

Gjithashtu, shtetasit E.SH. e P.Ç. gjatë regjistrimit të pasurive kanë ndryshuar zërin kadastral të sipërfaqes së regjistruar në pronësi të shtetasve K.H., etj, nga tokë arë në tokë pa frut, pa një akt administrativ nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Bujqësisë apo Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier.

Masat e sigurimit personal dhe pasuror u ekzekutuan nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të **Drejtorisë Vendore të Policisë Fier** në bashkëpunim me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 2 dhe Nr. 3 Tiranë, si dhe të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë.

LAJME TË NGJASHME



Gjykata Speciale e dënoi me 25 vite burg – Reagimi i parë nga Hashim Thaçi!

4 MIN



"Kur u njoha me të, ishte në burg", rrëfimi prekës i gruas së Jakup Krasniqit pas dënimit në Hagë: E prisnim në shtëpi, i kam premtuar se...


2 MIN





REL: Aktgjykimi i Hagës përballë historisë së luftës së Kosovës!

9.5 MIN



U përfshi në konfliktin e përgjakshëm, Alket Rizai i zhdukur prej 4 ditësh! Autoritetet greke dyshojnë se mund të jetë fshehur në Shqipëri!

1 MIN



Shoqata Evropiane e Gjyqtarëve kundër projektligjit për pagat e gjyqtarëve: Po anashkalohej Kushtetuesja!

1.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Të paguhesh për të lexuar, kjo po ndodh në Singapor!



Papa Leoni XIV paralajmëron për rrezikun e Inteligjencës Artificiale!



Majko përlotet pas vendimit për ish-liderët e UÇK: Dramë njerëzore e jashtëzakonshme, mund të cenojë historinë!



Lorenc Hasrama: "Kam zgjedhur të jap më të mirën, festivalet..."




Nga Guardian te Reuters dhe Al Jazeera, çfarë shkruajnë mediat ndërkombëtare për vendimin e Gjykatës së Hagës për liderët e UÇK-së



Trupi gjyqësor: Të katërt ish-anëtarët e UÇK-së penalisht përgjegjës për krime lufte



LAJMI I FUNDIT/ Kadri Veseli dënohet me 18 vite burg



Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dënohet me 25 vjet burgim për krime lufte



Haga/ Krasniqi dënohet me 25 vite burgim



Rexhep Selimi dënohet me 13 vjet burgim

EDITORI SUGJERON



"Prej pesë vitesh duam një fëmijë..." / Çiljeta Xhilaga zbulon planet me Albanin: Kam menduar të bëj in vitro!



"Të kisha çerekun e egrove të kolegeve të mia..." / Çiljeta Xhilaga: Nuk kam vuajtur për vëmendje!




10 shenjat që tregojnë se ushqimi duhet të hidhet para se të...



Pjeshkat apo bananet?! Cili frut është më i mirë për sheqerin në gjak dhe kaliumin...



10 pjesët më të mira të mishit të vicit për proteina me pak yndyrë!



Pilula eksperimentale imiton hormonin që prodhohet gjatë aktivitetit fizik intensiv!





Çfarë nuk duhet të mungojë në dietën tuaj për flokë të shëndetshëm...



Lorenc Hasrama risjell këngën e Flori Mumajesit live në studio!



Lorenc Hasrama kujton situatën më qesharake që i ka ndodhur në koncert!



Cili ka qenë përfaqësimi më i mirë në "Eurovision" sipas Lorenc Hasramës...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

[Kontaktimi](#)
[Marketing](#)
[Frekuencat](#)
[Aksesueshmëria](#)
[Mundësi Punësimi](#)
[Privacy Policy & Terms](#)

JavaScript is required for [tabnav widget](#) to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.